



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 04.03.2025, nxjerrë këtë:

### V E N D I M

- I. Mbyllt rasti Nr. prot. (APK-DPKI-06-1606/24), për zyrtarin e lartë publik z. Hilmi Shala, Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

### A r s y e t i m

- I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Hilmi Shala, Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/1-011, Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (*citojmë*): “*Hilimi Shala mban dy pozita udhëheqëse në Spitalin Rajonal Gjakova, Drejtor Ekzekutiv dhe Shef i Barnatores Qendrore. Kjo situatë krijon konflikt interesit dhe është shkelje të Ligjit Nr.06/L-114 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, veçanërisht nenin 3 alinia 1, i cili e ndalon zyrtarët publikë të ushtrojnë më shumë se një funksion në të njëjtin institucion publik. Kjo shkelje rrezikon integritetin e administratës publike dhe besimin e qytetarëve në institucionin shëndetëso.*”

Agjenci për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar ne dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-1606/24, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Hilmi Shala, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më qëllim të sqarimit të plotë të pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit për zyrtarin e lartë publik z. Hilmi Shala, Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin në fjalë, me ç'rast i njëjtë është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit, të ngritura për konflikt të interesit.

Në takim, zyrtari i lartë publik ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë duke theksuar: “*Drejtori Ekzekutiv i Spitalit është përgjegjës për punët operative dhe profesionale në spital. Barnatorja Qendrore është ne kuadër të Spitalit, ku është emëruar (zpj. L.A) ushtruese detyre e cila i raporton udhëheqësit të drejtpërdrejt, ndërsa sa përket furnizimit dhe planifikimit edhe Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA), sipas nevojës*”.

Nga informatat që përmban kërkesa e raportuesit të rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur si dhe informacioni/ dokumentacioni i siguruar sipas detyrës zyrtare rezulton gjendja faktike si në vijim:

Kontrata e punës për kohë të caktuar Nr. 02/2024, datë 08.05.2024, e z. Hilim Shala, Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë; Vendimi nr. 3707, datë 20.12.2023, znj. L. A., caktohet Ushtruese Detyre, Përgjegjëse në Barnatoren e Spitalit të Përgjithshme “Isa Grezda” në Gjakovë; Kontrata e punës për kohë të caktuar Nr. 3773, Ushtruese Detyre-Përgjegjës në Barnatore të Spitalit e znj. L.A; Shkresa me nr. 2145, datë 10.06.2024, znj. L. A., caktohet Ushtruese Detyre Përgjegjëse në Barnatoren Qendrore.

Andaj, bazuar në gjendjen faktike si më lartë, diskutimit nga takimi i mbajtur me zyrtarin e lartë z. Shala, si dhe dokumentacionet në dispozicion (*vendimin nr.3707, kontratën për kohë ta caktua nr.3773 për znj. L.A. Ushtruese Detyre-Përgjegjëse për Barnatoren e Spitalit, kontratën për punë me kohë të caktuar nr.02/2024, për z. Shala , Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë, si dhe shkresa me nr.2145, të dt. 10.06.2024, për znj. L.A. Ushtruese Detyre-Përgjegjëse në Barnatoren Qendrore*), Agjencia për Parandalimin e Korruptionit duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstaton se *nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e situatës së konfliktit të interesit*, për zyrtarin e lartë z. Hilmi Shala, përfaktin se i njëjti është duke ushtruar vetëm funksionin e Drejtorit të Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë, dhe nuk ushtron asnjë funksion tjeter, përfshirë atë në Barnatoren Qendrore të Spitalit. Ndërsa pozitën ushtrues detyre, përgjegjëse në Barnatoren Qendrore, e ushtron znj. L.A, e cila i raporton U.D. Drejtorit të Infermierisë.

Agjencia për Parandalimin e Korruptionit, në rastin konkret nuk ka gjetur fakte se z. Shala është duke ushtruar detyrën e zyrtarit përgjegjës të Barnatores Qendrore, andaj në këtë rast nuk kemi vërtetuar ndonjë element që përcakton kufizime apo ndalesa të cilat parashihen me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Duhet theksuar se, gjatë ushtrimit të funksionit, zyrtari i lartë duhet të ketë parasysh dispozitën e nenit 11 i cili përcakton *Punët e ndaluara për zyrtarin*, e në rastin tuaj duhet zbatuar nenin 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, ku ndalohej punët të cilat kanë të bëjnë me:

*1.4. angazhimi ka të bëjë me zgjidhjen, emërimin apo caktimin ne institucionin vartës të institucionit punëdhënës, me përjashtim kur një angazhim i tillë është paraparë me ligj të veçantë.*

**II.** Agjencja vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: “*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimitarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë*”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

Ylli BULESHKAJ  
Drejtëor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korruptionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtoret të DPKI-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)